

Rregullore (KE) nr. 1830/2003 e Parlamentit European dhe e Këshillit, datë 22 shtator 2003, mbi gjurmueshmërinë dhe etiketimin e organizmave të modifikuara gjenetikisht dhe gjurmueshmërinë e ushqimeve dhe ushqimeve për kafshët të prodhuara nga organizma të modifikuara gjenetikisht dhe ndryshimet në Direktivën 2001/18/KE

Gazeta Zyrtare L 268 , 18/10/2003 Fq. 0024 - 0028

Rregullore (KE) nr. 1830/2003 e Parlamentit European dhe e Këshillit, datë 22 shtator 2003, mbi gjurmueshmërinë dhe etiketimin e organizmave të modifikuara gjenetikisht dhe gjurmueshmërinë e produkteve ushqimore dhe produkteve ushqimore për kafshët të prodhuara nga organizma të modifikuara gjenetikisht dhe ndryshimet në Direktivën 2001/18/KE

PARLAMENTI EUROPIAN DHE KËSHILLI I BASHKIMIT EUROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin Themelues të Komunitetit European dhe veçanërisht nenin 95, pika 1 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit [1],

Duke pasur parasysh opinionin e Komitetit Ekonomik dhe Social [2],

Duke pasur parasysh opinionin e Komitetit të Rajoneve [3],

Duke vepruar në përputhje me procedurat e përcaktuara nga neni 251 i Traktatit [4],

Duke pasur parasysh se:

(1) Direktiva 2001/18/KE e Parlamentit European dhe e Këshillit, datë 12 mars 2001, për lëshimin e paramenduar në mjedis të organizmave të modifikuara gjenetikisht [5] u kërkon Shteteve Anëtare të marrin masa për të siguruar gjurmueshmërinë dhe etiketimin e organizmave të modifikuara gjenetikisht (OMGJ) të autorizuara, në të gjitha fazat e vendosjes së tyre në treg.

(2) Ndryshimet ndërmjet ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative kombëtare për gjurmueshmërinë dhe etiketimin e OMGJ-ve si produkte ose në produkte, si dhe gjurmueshmëria e ushqimit dhe ushqimit për kafshë të prodhuar nga OMGJ-të, mund të pengojnë lëvizjen e lirë të tyre, duke krijuar kushte të konkurrencës së pabarabartë dhe të pandershme. Një kuadër i harmonizuar komunitar për gjurmueshmërinë dhe etiketimin e OMGJ-ve duhet të kontribuojë në funksionimin efektiv të tregut të brendshëm. Prandaj Direktiva 2001/18/KE duhet të ndryshohet duke marrë në konsideratë këtë fakt.

(3) Kërkesat e gjurmueshmërisë të OMGJ-ve duhet të lehtësojnë si tërheqjen e produkteve kur shkaktajnë efekte të dëmshme, të paparashikuara mbi shëndetin e njeriut, shëndetin e kafshëve ose mjedisin, përfshirë ekosistemet, ashtu edhe objektin e monitorimit për të shqyrtuar pasojat e mundshme sidomos mbi mjedisin. Gjurmueshmëria duhet të lehtësojë gjithashtu zbatimin e masave të menaxhimit të riskut në përputhje me parimin e parandalimit.

(4) Duhet të përcaktohen kërkesat e gjurmueshmërisë për ushqimin dhe ushqimin për kafshët, të prodhuar nga OMGJ-të, me qëllim që të lehtësohet etiketimi i këtyre produkteve, në përputhje me kërkesat e Rregullores (KE) nr. 1829/2003 të Parlamentit European dhe të Këshillit, datë 22 shtator 2003, për ushqimin e modifikuar gjenetikisht për njerëz dhe kafshë [6], në mënyrë që të sigurohet informimi ë i saktë i operatorëve dhe konsumatorëve për të bërë të mundur ushtrimin prej tyre të lirisë së zgjedhjes në mënyrë efikase, si edhe që të bëhet i mundur kontrolli dhe verifikimi i kërkesave për etiketim. Kërkesat për ushqimin e njerëzve dhe kafshëve, të prodhuar nga OMGJ-të, duhet të jenë të ngjashme për të shmangur ndërprerjet e informacionit në rast të ndryshimeve të përdorimit të fundit. f

(5) Përcjellja dhe mbajtja e informacionit që produktet përmbajnë ose përbëhen nga OMGJ-të dhe kodet unike për ato OMGJ, në çdo fazë të vendosjes së tyre në treg, ofron bazën për gjurmueshmërinë dhe etiketimin e përshtatshëm të OMGJ-ve. Kodet mund të përdoren për të marrë informacion specifik për OMGJ-të nga një regjistër dhe për të lehtësuar identifikimin, zbulimin dhe monitorimin e tyre në përputhje me Direktivën 2001/18/KE.

(6) Përcjellja dhe mbajtja e informacionit që ushqimi dhe ushqimi për kafshë, janë prodhuar nga OMGJ ofron gjithashtu bazën për gjurmueshmërinë e duhur të produkteve të prodhuara nga OMGJ.

(7) Legjislacioni komunitar në lidhje me OMGJ-të si ose në ushqimin për kafshë duhet të zbatohet gjithashtu për ushqimin për kafshët të cilat destinohen për prodhim ushqimor.

(8) Duhet të hartohen udhëzime për marrjen e mostrave dhe zbulimin, me qëllim që të lehtësohet një përjasje e koordinuar për kontrollin dhe inspektimin, dhe të ofrohet siguri ligjore për operatorët. Duhet të merren në konsideratë regjistrat e krijuar nga Komisioni, në përputhje me nenin 31 pika 2 të Direktivës 2001/18/KE dhe nenin 29 të Rregullores nr. 1829/2003, të cilët përmbajnë informacion për modifikimet gjenetike në OMGJ.

(9) Shtetet Anëtare duhet të përcaktojnë rregulla për sanksionet që zbatohen për shkeljen e dispozitave të kësaj rregulloreje.

(10) Disa gjurmë të OMGJ-ve në produkte mund të jenë rastësore ose teknikisht të pashmangshme. Kjo prezencë e OMGJ-ve nuk duhet të çojë në kërkesa për etiketim dhe gjurmim. Prandaj është e nevojshme të vendosen kufij për praninë rastësore ose teknikisht të pashmangshme të materialit që përbëhet, përmban ose prodhohet nga OMGJ-të si kur autorizohet tregtimi i këtyre OMGJ-ve ashtu edhe kur prania e tyre rastësore ose teknikisht e pashmangshme tolerohet për shkak të nenit 47 të Rregullores (KE) nr. 1829/2003. Gjithashtu, është me vend të parashikohet që, kur niveli i kombinuar i prezencës rastësore ose teknikisht të pashmangshme të materialit të mësipërm në ushqim për njerëzit ose për kafshët, ose në një nga përbërësit e tij, është më i lartë se kufijtë e mësipërm të etiketimit, kjo prezencë duhet të tregohet në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje dhe dispozitat e hollësishme që duhen miratuar në zbatim të saj.

(11) Është e nevojshme të sigurohet që konsumatorët të informohen plotësisht dhe në mënyrë të besueshme për OMGJ-të dhe produktet, ushqimet dhe ushqimet për kafshë të prodhuara prej tyre, me qëllim që ata të bëjnë zgjedhjen e duhur për produktin.

(12) Masat e nevojshme për zbatimin e kësaj rregulloreje duhet të miratohen në përputhje me Vendimin e Këshillit 1999/468/KE, datë 28 qershor 1999, që përcakton procedurat për ushtrimin e kompetencave zbatuese që i janë dhënë Komisionit [7].

(13) Sistemet për krijimin dhe caktimin e identifikuesve unik për OMGJ-të duhet të krijohen përpara zbatimit të masave në lidhje me gjurmueshmërinë dhe etiketimin.

(14) Komisioni duhet të paraqesë një raport përpara Parlamentit Europian dhe Këshillit për zbatimin e kësaj rregulloreje dhe, sidomos, për efikasitetin e rregullave të gjurmueshmërisë dhe etiketimit.

(15) Kjo rregullore respekton të drejtat themelore dhe zbaton parimet e njohura në veçanti nga Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Europian,

KANË MIRATUAR KËTË RREGULLORE

Neni 1
Qëllimi

Kjo rregullore ofron një kuadër për gjurmueshmërinë e produkteve, të cilat përbëhen ose përmbajnë organizma të modifikuar gjenetikisht (OMGJ) dhe ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë të prodhuara nga OMGJ-të, me qëllim lehtësimin e etiketimit të saktë, monitorimin e ndikimit mbi mjedisin dhe, sipas rastit, mbi shëndetin dhe zbatimin e masave të duhura të menaxhimit të riskut duke përfshirë, nëse është e nevojshme, tërheqjen e produkteve.

Neni 2

Fusha e veprimit

1. Kjo rregullore zbatohet në të gjitha fazat e vendosjes në treg për:

- (a) produktet që përbëhen, ose përmbajnë OMGJ të vendosura në treg në përputhje me legjislacionin komunitar;
- (b) ushqimet e prodhuara nga OMGJ-të, të hedhura në treg në përputhje me legjislacionin komunitar;
- (c) ushqimet për kafshë të prodhuara nga OMGJ-të, të vendosura në treg në përputhje me legjislacionin komunitar.

2. Kjo rregullore nuk zbatohet për produktet mjekësore për përdorim njerëzor dhe veteriner të autorizuar sipas Rregullores (KEE) nr. 2309/93 [8].

Neni 3

Përkufizime

Për qëllimet e kësaj rregulloreje:

1. “Organizëm i modifikuar gjenetikisht” ose “OMGJ” është organizëm i modifikuar gjenetikisht siç përcaktohet në nenin, 2 pika 2 të Direktivës 2001/18/KE, me përjashtim të organizmave të përfuara nëpërmjet teknikave të modifikimit gjenetik të listuara në Shtojcën IB të Direktivës 2001/18/KE;

2. “Prodhuar nga OMGJ-të” do të thotë që rrjedhin, tërësisht ose pjesërisht, nga OMGJ-të, por që nuk përmbajnë ose nuk përbëhen nga OMGJ-të;

3. “Gjurmueshmëri” është aftësia për të gjurmuar OMGJ-të dhe produktet e prodhuara nga OMGJ-të, në të gjitha fazat e hedhjes së tyre në treg, nëpërmjet zinxhirit të prodhimit dhe shpërndarjes;

4. “Identifikues unik” është një kod i thjeshtë numerik ose alfanumerik që shërben për të identifikuar një OMGJ në bazë të një procesi transformimi të autorizuar, nga i cili është prodhuar, dhe që ofron mënyrat për të rimarrë informacionin specifik që i përket asaj OMGJ-je;

5. “Operator” është një person fizik ose juridik që hedh në treg një produkt ose që merr një produkt të hedhur në tregun komunitar, nga një Shtet Anëtar ose nga një vend i tretë, në çdo fazë të zinxhirit të prodhimit dhe shpërndarjes, por që nuk përfshin konsumatorin e fundit ;

6. “Konsumator i fundit ” është konsumatori i fundit i produkteve ushqimore, që nuk e përdor produktin ushqimor si pjesë të biznesit ushqimor .

7. “Ushqim” është ushqimi siç përcaktohet në nenin 2 të Rregullores (KE) nr. 178/2002 [9];

8. “Përbërës” është përbërësi, siç përcaktohet në nenin 6 pika 4 të Direktivës 2000/13/KE [10];

9. “Ushqim për kafshë” është ushqimi për kafshë siç përcaktohet në nenin 3 pika 4 të Rregullores (KE) nr. 178/2002;

10. “vendosje në treg” është vendosja në treg siç përcaktohet në legjislacionin komunitar specifik, sipas të cilit produkti në fjalë është autorizuar; në raste të tjera, përcaktohet si në nenin 2 pika 4 të Direktivës 2001/18/KE;

11. “Faza e parë e vendosjes në treg të një produkti” është veprimi fillestar në zinxhirin e prodhimit dhe shpërndarjes, kur produkti i vihet në dispozicion një pale të tretë;

12. “Produkt i paraambalazhuar” është çdo artikull i ofruar për shitje, i cili përbëhet nga një produkt dhe ambalazhi ku ai vendoset përpara se të ofrohet për shitje, qoftë kur produkti është ambalazhuar tërësisht apo pjesërisht, me kusht që përmbajtja të mos ndryshojë pa hapur ose pa ndryshuar ambalazhin.

Neni 4

Kërkesat për gjurmueshmërinë dhe etiketimin e produkteve ushqimore që përbëhen ose përmbajnë OMGJ

A. GJURMUESHMËRIA

1. Në fazën e parë të vendosjes në treg të një produkti që përbëhet ose përmban OMGJ, përfshirë sasinë me shumicë, operatorët sigurojnë që operatorit që merr produktin t’i përcillet me shkrim informacioni i mëposhtëm:

(a) që produkti përmban ose përbëhet nga OMGJ;

(b) identifikues/it unik i/të caktuar për ato OMGJ në përputhje me nenin 8.

2. Në të gjitha fazat vijuese të hedhjes në treg të produkteve të përmendura në pikën 1, operatorët sigurojnë që operatorëve që marrin produktet t’iu përcillet me shkrim informacioni i marrë në përputhje me pikën 1.

3. Në rastin e produkteve që përbëhen nga, ose që përmbajnë përzierje të OMGJ-ve të cilat duhen përdorur vetëm dhe direkt si ushqim për njerëz, ose për kafshë ose për përpunim, informacioni i përmendur në pikën 1 shkronja b mund të zëvendësohet me një deklaratë përdorimi nga operatori, të shoqëruar me një listë të identifikuesve unik për të gjitha ato OMGJ që janë përdorur në përzierje.

4. Operatorët, pa përjashtuar nenin 6, përdorin sisteme dhe procedura standarde që lejojnë mbajtjen e informacionit të specifikuar në pikën 1, 2 dhe 3 dhe identifikimin, për një periudhë pesë vjeçare nga çdo transaksion, e operatorit nga i cili, dhe operatorit për të cilin janë vënë në dispozicion produktet e përmendura në pikën 1.

5. Pikat 1 deri në 4 nuk cenojnë kërkesat e tjera specifike të legjislacionit komunitar.

B. ETIKETIMI

6. Për produktet që përbëhen nga ose përmbajnë OMGJ, operatorët sigurojnë që:

(a) për produktet e paraambalazuara, të cilat përbëhen nga ose përmbajnë OMGJ, fjalët “Ky produkt përmban organizma të modifikuara gjenetikisht” ose “Ky produkt përmban organizma [emri i organizmit/organizmave] të modifikuara gjenetikisht” të tregohen në etiketë;

(b) për produkte të pa paraambalazuara që i ofrohen konsumatorit të fundit r fjalët “Ky produkt përmban organizma të modifikuara gjenetikisht” ose “Ky produkt përmban organizma [emri i organizmit/organizmave] të modifikuara gjenetikisht” të tregohet në, ose lidhur me paraqitjen e produktit.

Kjo pikë nuk cenon kërkesat e tjera specifike të legjislacionit komunitar.

C. PËRJASHTIME

7. Pikat 1 deri në 6 nuk zbatohen për gjurmët të OMGJ-ve në produkte, në një përmbajtje jo më të lartë se kufijtë e përcaktuar në përputhje me nenin 21 pika 2 ose 3 të Direktivës 2001/18/KE, dhe në legjislacionin tjetër specifik komunitar, nëse këto gjurmë të OMGJ-ve janë rastësore ose teknikisht të pashmangshme.

8. Pikat 1 deri në 6 nuk zbatohen për gjurmët e OMGJ-ve në produkte që janë përcaktuar për përdorim të drejtpërdrejtë si ushqim, ushqim për kafshë ose përpunim në përmbajtje jo më të lartë se kufijtë e përcaktuar për ato OMGJ në përputhje me nenet 12, 24 ose 47 të Rregullores (KE) nr. 1829/2003, nëse këto gjurmë të OMGJ-ve janë rastësore ose teknikisht të pashmangshme.

Neni 5

Kërkesat për gjurmueshmërinë për produktet për ushqimet dhe ushqimet për kafshë të prodhuara nga OMGJ-të

1. Kur operatorët vendosin në treg produkte të prodhuara nga OMGJ-të, ata duhet të sigurojnë që operatorit që merr produktin t'i jepet me shkrim informacioni i mëposhtëm:
 - (a) një tregues për çdo përbërës ushqimor që është prodhuar nga OMGJ-të;
 - (b) një tregues për çdo material ose aditiv për ushqimin për kafshë që është prodhuar nga OMGJ-të;
 - (c) në rastin e produkteve për të cilët nuk ka listë të përbërësve, të tregohet që produkti është prodhuar nga OMGJ-të.
2. Pa përjashtuar nenin 6, operatorët duhet të përdorin sisteme dhe procedura standarde për mbajtjen e informacionit të specifikuar në pikën 1, dhe identifikimin, për një periudhë pesë vjeçare nga çdo transaksion, për operatorin nga i cili dhe operatorin për të cilin janë vënë në dispozicion produktet e përmendura në pikën 1.
3. Pikat 1 dhe 2 nuk prekin kërkesat e tjera specifike të legjislacionit komunitar.
4. Pikat 1, 2 dhe 3 nuk zbatohen për gjurmët të OMGJ-ve në produktet për ushqim dhe ushqim për kafshë, të prodhuara nga OMGJ-të, në një përmbajtje jo më të lartë se kufijtë e përcaktuar për ato OMGJ në përputhje me Nenet 12, 24 ose 47 të Rregullores (KE) nr. 1829/2003, nëse këto gjurmë të OMGJ-ve janë rastësore ose teknikisht të pashmangshme.

Neni 6

Përjashtime

1. Në rastet kur legjislacioni komunitar parashikon sisteme specifike identifikimi, si numri i lotit, për produkte të paraambalazuara, operatori nuk është i detyruar të mbajë informacionin e specifikuar në nenet 4 pika 1, 4 pika 2, 4 pika 3 dhe 5 pika 1, nëse ky informacion dhe numri i lotit shënohen dukshëm në ambalazh dhe nëse informacioni për numrin e lotit ngarkesës mbahet për periudhën kohore të përmendur në nenet 4 pika 4 dhe 5 pika 2.
2. Pika 1 nuk zbatohet për fazën e fillestare të hedhjes në treg të një produkti, ose për prodhimin primar ose riambalazhimin e një produkti.

Neni 7

Ndryshime të Direktivës 2001/18/KE

Direktiva 2001/18/KE ndryshohet si vijon:

1. Hiqet neni 4 pika 6;
2. Pika e mëposhtme i shtohet nenit 21:

"3. Për produktet e destinuar për përpunim të drejtpërdrejtë, pika 1 nuk zbatohet, për përmbajtjet gjurmë të OMGJ-ve të autorizuar, në përqindje jo më të lartë se 0.9 % ose në kufij më të ulët, të përcaktuar sipas dispozitave të nenit 30 pika 2, nëse këto gjurmë janë rastësore ose teknikisht të pashmangshme."

Neni 8

Identifikuesit unikë

Në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 10 pika 2, Komisioni:

- (a) përpara zbatimit të neneve 1 deri në 7, krijon një sistem për përcaktimin e identifikuesve unik për OMGJ-të;
 - (b) përshtat sistemin e parashikuar në shkronjën (a), sipas rastit.
- Në këtë veprim, merren parasysh zhvillimet në forumet ndërkombëtare.

Neni 9

Masa për inspektimin dhe kontrollin

1. Shtetet Anëtare, sigurojnë që kryhen inspektimet dhe masat e tjera të kontrollit, përfshirë kontrollin dhe analizimin (cilësor dhe sasior) të mostrave, sipas rastit, për të siguruar zbatimin e kësaj rregulloreje. Inspektimi dhe masat e kontrollit, mund të përfshijnë gjithashtu inspektimin dhe kontrollin në lidhje me mbajtjen e produktit.
2. Komisioni, përpara zbatimit të neneve 1 deri në 7, në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 10 pika 3, harton dhe publikon një udhëzues teknik për marrjen e mostrave dhe testimin, me qëllim që të lehtësojë një përfaqje të koordinuar për zbatimin e pikës 1 të këtij neni. Komisioni, gjatë hartimit të udhëzuesit teknik të sipërpërmendur, merr parasysh punën e autoriteteve përgjegjëse kombëtare, Komitetit të përmendur në nenin 58 pika 1 të Rregullores (KE) nr. 178/2002 dhe Laboratorit Komunitar të Referimit krijuar me Rregulloren (KE) nr. 1829/2003.
3. Komisioni, për të ndihmuar Shtetet Anëtare të plotësojnë kërkesat e përcaktuara në pikat 1 dhe 2, siguron krijimin e një regjistri qendror në nivel komunitar, që të përmbajë gjithë informacionin vijues dhe materialin e referimit për OMGJ-të e autorizuara që do të vendosen në treg në Komunitet. Autoritetet përgjegjëse në Shtetet Anëtarë kanë mundësi përdorimi të regjistrit. Regjistri, aty ku është e mundur, përmban informacionin përkatës në lidhje me OMGJ-të që nuk janë të autorizuara në Bashkimin Europian.

Neni 10

Komiteti

1. Komisioni mbështetet nga Komiteti i krijuar me nenin 30 të Direktivës 2001/18/KE.
2. Kur referohet kjo pikë zbatohen nenet 5 dhe 7 të Vendimit 1999/468/KE duke pasur parasysh dispozitat e nenit 8 të tij.
Periudha e përcaktuar në nenin 5 pika 6 të Vendimit 1999/468/KE, përcaktohet për tre muaj.
3. Kur përmendet kjo pikë zbatohen nenet 3 dhe 7 të Vendimit 1999/468/KE duke pasur parasysh dispozitat e nenit 8 të tij.
4. Komiteti miraton rregulloren e tij të brendshme.

Neni 11

Sanksionet

Shtetet Anëtare përcaktojnë rregullat për sanksionet që merren për shkeljen e dispozitave të kësaj rregulloreje, dhe marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar zbatimin e tyre. Sanksionet e parashikuara duhet të jenë të efektshme, proporcionale dhe ndaluese. Shtetet Anëtare e venë në dijeni Komisionin për këto dispozita jo më vonë se 18 prilli 2004 dhe e njoftojnë pa vonesë për ndonjë ndryshim të mëvonshëm që ka ndikim tek ato.

Neni 12

Klauzola e rishikimit

Komisioni, jo më vonë se data 18 tetor 2005, i përcjell Parlamentit Europian dhe Këshillit, një raport për zbatimin e kësaj rregulloreje, sidomos në lidhje me nenin 4 pika 3 dhe, sipas rastit, i paraqet një propozim.

Neni 13

Hyrja në fuqi

1. Kjo rregullore hyn në fuqi njëzet ditë pas botimit të saj në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Europian.

2. Nenet 1 deri në 7 dhe neni 9 pika 1 zbatohen nëntëdhjetë ditë pas datës së publikimit në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Europian të masës së përmendur në nenin 8 shkronja (a).

Kjo rregullore është e detyrueshme në tërësinë e saj dhe drejtpërdrejt e zbatueshme në të gjitha Shtetet Anëtare.

Nënshkruar në Bruksel, më 22 shtator 2003.

Për Parlamentin Europian

Presidenti

P. Cox

Për Këshillin

Presidenti

R. Buttiglione

[1] GZ C 304 E, 30.10.2001, fq. 327 dhe GZ C 331 E, 31.12.2002, fq.308.

[2] GZ C 125, 27.5.2002, fq. 69.

[3] GZ C 278, 14.11.2002, fq. 31.

[4] Opinioni i Parlamentit Europian, datë 3 korrik 2002 (ende i papublikuar në Gazetën Zyrtare), Qëndrimi i Përbashkët i Këshillit, datë 17 mars 2003 (GZ C 113 E, 13.5.2003, fq. 21), Vendimi i Parlamentit Europian, datë 2 korrik 2003 (ende i papublikuar në Gazetën Zyrtare) dhe Vendimi i Këshillit, datë 22 korrik 2003.

[5] GZ L 106, 17.4.2001, fq 1. Direktivë e ndryshuar së fundi nga Vendimi i Këshillit 2002/811/KE (GZ L 280, 18.10.2002, fq 27).

(6) Shih faqen 1 të kësaj Gazete Zyrtare.

[7] GZ L 184, 17.7.1999, fq 23.

[8] Rregullore e Këshillit (KEE) nr. 2309/93, datë 22 korrik 1993, që përcakton procedurat komunitare për autorizimin dhe mbikëqyrjen e produkteve mjekësore për përdorim njerëzor dhe veteriner dhe që krijon Agjencinë Europiane për Vlerësimin e Produkteve Mjekësore (GZ L 214, 24.8.1993, fq.1). Rregullore e ndryshuar së fundi nga Rregullorja (KE) nr. 807/2003 (GZ L 122, 16.5.2003, fq 36).

[9] Rregullore (KE) nr. 178/2002 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 28 janar 2002, që përcakton parimet e përgjithshme dhe kërkesat e legjislacionit për ushqimin, që krijon Autoritetin Europian për Sigurinë Ushqimore dhe që përcakton procedurat në çështje të sigurisë ushqimore (GZ L 31, 1.2.2002, fq 1).

[10] Direktivë 2000/13/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 20 mars 2000, për përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me etiketimin, paraqitjen dhe reklamimin e produkteve ushqimore (GZ L 109, 6.5.2000, fq 29). Direktivë e ndryshuar nga Direktiva e Komisionit 2001/101/KE (GZ L 310, 28.11.2001, fq 19).